

**Emertimi dhe Forma Ligjore**

**"KAJO" SHPK**

**NIPT-I**

**Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar**

**K52602003C**

**Adresa e Selise**

**Komuna Poshnje, Ure Vajgurore**

**Data e krijimit**

**29.10.2004**

**Nr. i Rregjistrimit Tregtar**

**32353**

**Veprimtaria kryesore**

**Tregti me shumice e pakice mallra  
ushqimor dhe prodhim embelsira.**

## **PASQYRAT FINANCIARE**

### **Viti 2014**

**Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare**

**Nga 01.01.2014 Deri 31.12.2014**

**DATA E MBYLLJES SE PASQYRAVE FINANCIARE 20.03.2015**

**PASQYRAT FINANCIARE JANE INDIVIDUALE INDIVIDUALE**

**PASQYRAT FINANCIARE JANE TE KONSOLIDUARA \_\_\_\_\_**

**PASQYRAT FINANCIARE JANE TE SHPREHURA NE LEKE**

**PASQYRAT FINANCIARE JANE TE RRUMBULLAKOSURA NE 0 LEKE**



**AS-Audit Services sh.p.k**

Adresa:Rr. "KOSOVAREVE", ND.35, H.2, Ap.7  
Njesia Bashkiake Nr.5,Tiranë  
(Prane Diges se Liqenit Artificial)

Cel: 069 20 99 204  
Tel/fax: (04) 2 430 084  
E-mail: [as-auditservices@hotmail.com](mailto:as-auditservices@hotmail.com)

## ***Raport i Audituesit të Pavarur***

**Për Ortakët e shoqërise "KAJO" sh.p.k**  
**Adresa selise: Poshnje, Berat.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të shoqërisë "KAJO" sh.p.k, të cilat përfshijnë bilancin kontabel të datës 31 Dhjetor 2014 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e fluksit të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin mbyllur në këtë datë, një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël, si dhe informacionin tjetër shpjegues.

### **Përgjegjësia e drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar(SKK-të), dhe për ato kontrole të brendëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale,qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit.

### **Përgjegjësia e Audituesit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit,përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit.Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendëshëm të entitetit.

Nje auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatëshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### Opinionit

*Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyre të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë "KAJO" sh.p.k, më datën 31 Dhjetor 2014, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur, në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar(SKK-të).*

### AS-Audit Services sh.p.k

Afrim Suli

Ortak Kryesor i Angazhimit



Tiranë, më 22.03.2015

# “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

## Pasqyra e bilancit kontabel me 31.12.2014

ZERI I BILANCIT		She nime	Viti ushtrimor 2014	Ushtrimi paraardhes 2013
<b>A</b>	<b>AKTIVET</b>			
<b>I</b>	<b>Aktivët Afatshkurtëra</b>			
<b>1</b>	<b>Mjete monetare</b>	3	3,307,620	3,602,384
<b>2</b>	<b>Derivative dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim</b>		0	0
(i)	-Derivatet		0	0
(ii)	-Aktivet e mbajtura për tregtim		0	0
	<b>Totali 2</b>		0	0
<b>3</b>	<b>Aktive të tjera financiare afatshkurtra</b>			
(i)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	4	11,948,273	3,925,121
(ii)	Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5	113,464	692,200
(iii)	Instrumente të tjera borxhi		0	0
(iv)	Investime të tjera financiare		0	0
	<b>Totali 3</b>		12,061,737	4,617,321
<b>4</b>	<b>Inventari</b>			
(i)	Lëndët e para	6	0	0
(ii)	Prodhim në proces	6	0	0
(iii)	Produkte të gatshme	6	0	0
(iv)	Mallra për rishitje	6	147,962,530	143,052,292
(v)	Parapagesat për furnizime	6	0	0
	<b>Totali 4</b>		147,962,530	143,052,292
<b>5</b>	<b>Aktivët biologjike afatshkurtra</b>		0	0
<b>6</b>	<b>Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje</b>		0	0
<b>7</b>	<b>Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b>		0	0
	<b>Totali i aktiveve afatshkurtera (I)</b>		<b>163,331,887</b>	<b>151,271,997</b>
<b>II</b>	<b>Aktivët afatgjata</b>			
<b>1</b>	<b>Investimet financiare afatgjata</b>			
(i)	Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		0	0
(ii)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje		15,000,000	0
(iii)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë		0	0
(iv)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		0	0
	<b>Totali 1.</b>		<b>15,000,000</b>	<b>0</b>
<b>2</b>	<b>Aktive afatgjata materiale</b>			
(i)	Toka	7	9,458,746	9,458,746
(ii)	Ndërtesa	7	34,197,322	34,597,722
(iii)	Makineri dhe pajisje	7	8,484,407	10,482,307
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	7	846,136	630,361
	<b>Totali 2</b>	7	<b>52,986,611</b>	<b>55,169,136</b>
<b>3</b>	<b>Aktivët Biologjike afatgjata</b>		0	0
<b>4</b>	<b>Aktivët afatgjata jomateriale</b>		0	0
(i)	Emri i mire		0	0
(ii)	Shpenzimet e zhvillimit		0	0
(iii)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale		0	0
	<b>Totali 4</b>		0	0
<b>5</b>	<b>Kapital aksionar i papaguar</b>		0	0
<b>6</b>	<b>Aktive të tjera afatgjata</b>		43,255,057	40,948,346
	<b>Totali i aktiveve Afatgjata (II)</b>		<b>111,241,668</b>	<b>96,117,482</b>
	<b>TOTALI I AKTIVEVE (I + II)</b>		<b>274,573,555</b>	<b>247,389,479</b>

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

B	DETYRIMET DHE KAPITALI		
<b>I</b>	<b>Detyrimet Afatshkurtëra</b>		
<b>1</b>	<b>Derivativët</b>		<b>0</b>
<b>2</b>	<b>Huamarrjet</b>		<b>0</b>
(i)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra	8	100,152,553
(ii)	Kthimet/ripagesat e huave afatgjata		5,960,000
(iii)	Bono të konvertueshme		0
	<b>Totali 2</b>	<b>8</b>	<b>106,112,553</b>
<b>3</b>	<b>Huat dhe parapagimet</b>		
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve	9	38,068,736
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve		0
(iii)	Detyrime tatimore	9	713,246
(iv)	Hua të tjera	9	0
(v)	Parapagimet e arkëtuara	9	0
	<b>Totali 3</b>	<b>9</b>	<b>38,781,982</b>
<b>4</b>	<b>Grantet dhe të ardhurat e shtyra</b>		<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Provizionet afatshkurtra</b>		<b>0</b>
	<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)</b>		<b>144,894,535</b>
<b>II</b>	<b>Detyrime afatgjata</b>		
<b>1</b>	<b>Huat afatgjata</b>		<b>16,390,000</b>
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare		16,390,000
(ii)	Bonot e konvertueshme		0
	<b>Totali 1</b>		<b>16,390,000</b>
<b>2</b>	<b>Huamarrje të tjera afatgjata</b>	10	9,000,000
<b>3</b>	<b>Provizionet afatgjata</b>		<b>0</b>
<b>4</b>	<b>Grantet dhe të ardhurat e shtyra</b>		<b>0</b>
	<b>Totali i detyrimeve afatgjata (II)</b>		<b>25,390,000</b>
	<b>Totali i detyrimeve (I+II)</b>		<b>170,284,535</b>
<b>III</b>	<b>Kapitali</b>		
<b>1</b>	<b>Aksionet e pakicës</b>		<b>0</b>
	<b>Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë</b>		
<b>2</b>	<b>mëmë</b>		<b>0</b>
<b>3</b>	<b>Kapitali aksionar</b>	11	88,138,000
<b>4</b>	<b>Primi i aksionit</b>		<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)</b>		<b>0</b>
<b>6</b>	<b>Rezerva statusore</b>		<b>0</b>
<b>7</b>	<b>Rezerva ligjore</b>	11	10,000
<b>8</b>	<b>Rezerva të tjera</b>	11	10,507,458
<b>9</b>	<b>Fitimet e pashpërndara</b>		<b>0</b>
<b>10</b>	<b>Fitimi (humbja) e vitit financiar</b>	12	5,633,562
	<b>Totali i kapitalit (III)</b>		<b>104,289,020</b>
	<b>TOTALI I DEYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)</b>		<b>274,573,555</b>
			<b>247,389,479</b>

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

### Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të Periudhës 1 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor 2014

(Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres)

		<b>Shëni me</b>	<b>Viti ushtrimor 2014</b>	<b>Ushtrimi paraardhes 2013</b>
1	Shitjet neto	12,1	366,395,915	392,736,670
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit		0	0
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces		0	0
4	Materialet e konsumuara	12,2	(331,581,591)	(356,412,625)
5	Kosto e punes	12,3	(12,523,281)	(13,615,785)
	<i>Pagat</i>		(10,731,173)	(11,667,335)
	<i>Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore</i>		(1,792,108)	(1,948,450)
6	Amortizimi dhe zhvleresimet	7	(1,413,572)	(1,262,157)
7	Shpenzime te tjera	12,4	(4,600,522)	(4,509,330)
8	<b>Totali i shpenzimeve (shuma 4-7)</b>		<b>(350,118,966)</b>	<b>(375,799,897)</b>
9	<b>Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+3-8)</b>		<b>16,276,949</b>	<b>16,936,773</b>
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		0	0
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		0	0
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	12.5	0	0
12,1	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata</i>		0	0
12,2	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>		(9,505,085)	(10,041,347)
12,3	<i>Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi</i>		0	(2,100)
12,4	<i>Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare</i>		0	0
13	<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)</b>		<b>(9,505,085)</b>	<b>(10,043,447)</b>
14	<b>Fitimi (humbja) para tatimit (9+10+11+12+/-13)</b>		<b>6,771,864</b>	<b>6,893,326</b>
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	12,6	1,138,302	747,099
16	<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)</b>		<b>5,633,562</b>	<b>6,146,227</b>
17	Elementet e pasqrave te konsoliduara		0	0

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

### Pasqyra e Fluksit monetar për Periudhën 1 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor 2014

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	She nime	Viti ushtrimor 2014	Ushtrimi paraardhes 2013
<b>Fluksi i monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>	12.7	6,771,864	6,893,326
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin	7	1,413,572	1,262,157
Humbje nga kembimet valutore			
Të ardhura nga investimet	13.2	(746)	320,248
Shpenzime per interesa	13.6	9,505,085	10,041,722
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti si dhe e kërkesave të tjera		(7,462,070)	918,825
Rritje/renie në tepricën e inventarit		(4,910,238)	(18,878,386)
Rritje/renie në tepricën e detyrimeve për të paguar nga aktiviteti		18,510,514	(11,875,678)
<b>Mjetet monetare të perfituara nga aktivitetet</b>		<b>23,827,981</b>	<b>(11,317,786)</b>
Interesi i paguar		(9,505,085)	(10,041,722)
Tatimfitimi i paguar	13.7	(1,120,648)	(483,696)
		0	0
<b><u>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</u></b>		<b>13,202,248</b>	<b>(21,843,204)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerje e shoqërisë së kontrolluar ____ minus parate e arkëtuar		(15,000,000)	
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(2,569,093)	(3,545,000)
Të ardhura nga shitja e paisjeve	13.2	1,032,079	746,417
Interesi i arkëtuar			
Dividendet e arkëtuar			
<b><u>Mjete monetare neto e perdorur në aktivitetet investuese</u></b>		<b>(16,537,014)</b>	<b>(2,798,583)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare</b>			
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		0	0
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	11	3,040,000	22,350,000
Pagesa e detyrimeve të qirase financiare			
Dividendet e paguar		0	0
		0	0
<b><u>Mjete monetare neto e perdorur në aktivitetet financiare</u></b>		<b>3,040,000</b>	<b>22,350,000</b>
<b>Rritja/rënia neto e mjeteve monetare</b>		<b>(294,764)</b>	<b>(2,291,787)</b>
<b>Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël</b>		<b>3,602,384</b>	<b>5,894,171</b>
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël</b>		<b>3,307,620</b>	<b>3,602,384</b>

**“KAJO” SH.P.K**

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

**Pasqyra e ndryshimeve të Kapitalit gjatë Periudhës 1 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor 2014 ne nje pasqyre te pakonsoliduar**

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione te thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2012</b>	88,138,000	-	-	11,896	4,359,335	92,509,231
Efekt ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni I rregulluar</b>	88,138,000	-	-	11,896	4,359,335	92,509,231
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	6,146,227	6,146,227
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	4,359,335	(4,359,335)	-
Emetimi i aksioneve(pjeseve te reja te kapitalit)	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2013</b>	88,138,000	-	-	4,371,231	6,146,227	98,655,458
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	5,633,562	5,633,562
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar (pjeseve te reja)	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	6,146,227	(6,146,227)	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2014</b>	88,138,000	-	-	10,517,458	5,633,562	104,289,020

**HARTUESI**

**LEFTER DOKO**

**PËR SHOQËRINË “KAJO” SH.P.K.**

**ADMINISTRATORI**

**SHKËLQIM KAJO**

KAJU SHPK  
BERAT  
K 52602003C

Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-15



# "KAJO" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

## **SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2014**

### **1. Informacione te pergjitheshme**

"KAJO" sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 29.10.2004 dhe gjendet e rregjistruar ne rregjistrin tregtar(QKR), identifikuar me NIPT K52602003C. Kapitali i rregjistruar aktualisht eshte 88.138.000 leke dhe zoterohet ne pjese te barabarta nga ortaket Shkelqim Kajo dhe Vladimir Kajo. Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2014 eshte tregtia me shumice e pakice e mallrave ushqimore.

### **2. Permbledhje e politikave kontabel**

#### **Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare' dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

#### **Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:**

##### **Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shumën të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitetet financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njësia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim, si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

##### **Aktivitetet financiare**

Shoqëria i klasifikon aktivitetet financiare në Llogari/Kërkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Drejtimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivitetet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

*Shumat shprehen në lekë*

kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësies për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethana që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumatat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimin të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

### **Transaksionet me monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2014 janë 1 euro=140.14 leke dhe 1 dollar=115.23 leke.

### **Inventarët**

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK-4 “Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjrisht, kur mbarë të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra për të sjellë inventarët në kushte magazinimi, kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri.

Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti).

Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të voglën midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes.

### **Aktivitet afatgjatë materiale**

Aktivitet afatgjatë materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta në zërin “tepricë nga rivlerësimi”. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën lineare, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndertesa 1 % dhe për aktivet e tjera 5% të vlerës fillestare.

### Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në përcaktimet e SKK-2. Huamarrjet afatshkurtra njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Llogaritë të pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e hartimit të pasqyrave financiare.

Huatë afatgjata vlerësohen në hyrje me koston dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

### Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabël. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

### Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin perfaqson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatimi fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2014 është 15% nga 10 % që ka qene në ushtrimin e mëparshëm. Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK-11 për tatimin e shtyrë.

### **3. Aktive monetare (likujditete në banke dhe arke)**

Gjendjet e mjeteve monetare, në lekë dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshte:

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2014		Gjendja ne 31.12.2013	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	leke	3,002,525		3,032,162	
Arka	leke	305,095		570,222	
<b>Shuma Mjete monetare</b>		<b>3,307,620</b>	<b>x</b>	<b>3,602,384</b>	<b>x</b>

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve, në llogaritë bankare dhe në arken e shoqërisë, konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të dates 31.12.2014 te Bankes se Shqiperise. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në valutë të huaj janë sistemuar në rezultatin financiar.

Nuk ka ndryshime në politikat kontabël të njohjes, vlerësimit dhe të konvertimit të veprimeve dhe gjendjeve të likuiditeteve ne Pasqyrat Financiare te vitii 2014.

#### 4. Aktive te tjera financiare afatshkurtera-Llogari/Kerkesa te arketueshme

Llogari/Kerkesa te arketushme jane te perbera si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Kliente per mallra, produkte e sherbime	11,948,273	3,925,121
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per mallra, prod.e sherb	0	0
Kliente per aktive afatgjata		
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per aktive afatgjata		
<b>Shuma Kerkesa te arketueshme</b>	<b>11,948,273</b>	<b>3,925,121</b>

Ne “Llogari / Kërkesa të arkëtueshme” jane pasqyruar kerkesat ndaj klienteve per shitjen e mallrave. Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

#### 5. Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme

Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme jane te perbera si vijon :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Debitore kreditore te tjere	0	0
Shteti tatime dhe taksa	113,464	692,200
Tatim mbi fitimin	113,464	692,200
Shteti-TVSH per tu marre	0	0
Shteti-tatime te tjera	0	0
Kliente pa faturuar		
<b>Shuma Kerkesa te tjera te arketushme</b>	<b>113,464</b>	<b>692,200</b>

#### 6. Inventari

Inventari eshte i perbere si vijon:

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>Mallra per Rishitje</b>	<b>147,962,530</b>	<b>143,052,292</b>
<b>Parapagime per furnizime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Shuma Inventar</b>	<b>147,962,530</b>	<b>143,052,292</b>

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike te kryera ne fund te ushtrimit 2014. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem.

Shuma e inventarit te paraqitur ne "Mallra per rishitje" perfaqeson stokun e mallrave qe perdoren per ti shitur, te vleresuara me kostot mesatare. Drejtimi gjykon se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kostos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk ka nevojë per zhvleresime te tij.

### 7. Investime ne shoqerite e kontrolluara dhe pjesemarrjet

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve te qendrueshme financiare ne pasqyrat financiare paraqiten:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Investime ne njesite e kontrolluara	0	0
Investime ne pjesemarrje	15,000,000	0
Pjersemarrje nbe shoqerine "JUOR" sh.p.k		
<b>Shuma Inventar</b>	<b>15,000,000</b>	<b>0</b>

Shoqeria ka marre pjese ne krijimin e shoqerise "JUOR" sh.p.k, me kapital te rregjistruar 200.000 leke. Shoqeria "Kajo" shpk zoteron 75% te kapitalit te shoqerise "JUOR" sh.p.k. Duke qene se keto pasqyra financiare jane individuale investimi i mesiperm fillimisht eshte njohur me kosto dhe me pas me kosto minus zhvleresimin.

### 8. Aktive afatgjata materiale

Aktivët Afatgjata Materiale (AAM-te) perbehen si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertime	Instalime teknike, makineri paisje, etj.	Mjete transporti	Paisje zyre e informatike	Totali
Kosto e AAM me 01.01.2014	9,458,746	40,039,810	2,389,724	14,958,282	857,945	67,704,510
Shtesat 2014	0	0	0	0	262,382	262,382
Pakesimet 2014	0	0	1,190,000	0	0	1,190,000
<b>Kosto e AAM me 31.12.2014</b>	<b>9,458,746</b>	<b>40,039,810</b>	<b>1,199,724</b>	<b>14,958,282</b>	<b>1,120,327</b>	<b>66,776,892</b>
Amortizimi AAM 01.01.2014	0	5,442,090	495,709	6,369,989	227,582	12,535,373
Amortizimi ushtrimor	0	400,398	218,653	747,914	46,607	1,413,572
Amortizimi per daljet AAM	0	0	158,667	0	0	158,667
<b>Amortizimi i AAM me 31.12.2014</b>	<b>0</b>	<b>5,842,488</b>	<b>555,695</b>	<b>7,117,903</b>	<b>274,190</b>	<b>13,790,278</b>
<b>Vlera neto e AAM 31.12.2013</b>	<b>9,458,746</b>	<b>34,597,720</b>	<b>1,894,015</b>	<b>8,588,293</b>	<b>630,363</b>	<b>55,169,137</b>
<b>Vlera neto e AAM 31.12.2014</b>	<b>9,458,746</b>	<b>34,197,322</b>	<b>644,028</b>	<b>7,840,379</b>	<b>846,136</b>	<b>52,986,611</b>

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

*Shumat shprehen në lekë*

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të perputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2014. Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Drejtimi mendon se pergjithësisht për këtë ushtrim kontabel, nuk ka shenja të rënjes në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime. Metodën dhe normën e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë njëjta me ato të vitit të kaluar (shih shënimin nr.2). Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efektet fiskale.

### 9. Detyrimet afatshkurtera-Huamarrjet

Huamarrjet (afatshkurtera) përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>Hua dhe obligacione afatshkurtera</b>		
Llogari bankare të zbuluara (overdraft)	100,152,553	99,044,153
<b>Shuma hua dhe obligacione afatshkurtera</b>	<b>100,152,553</b>	<b>99,044,153</b>
<b>Kthimet/ripagesat e huave afatgjata</b>	5,960,000	5,960,000
<b>Shuma Huamarrjet</b>	<b>105,004,153</b>	<b>130,570,318</b>

Për financimin e veprimtarisë së saj shoqëria ka marrë overdraft nga “ALPHA” Bank sh.a tepërca e së cilës më 31.12.2014 është 100.152.553 lekë.

“Kthimet/ripagesat e huave afatgjata” përfaqësojnë kështu kredite afatgjate që do paguhesh brenda 12 muajve të ardhshëm të marrë në “ALPHA” Bank sh.a. Shih shënimin nr.10 në të cilin janë trajtuar kredite e marra.

### 10. Detyrimet afatshkurtera-Huate dhe Parapagimet

Huate dhe parapagimet përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>Te pagueshme ndaj furnitorëve</b>		
Furnitore për mallra, produkte e shërbime	38,068,736	20,894,982
<b>Detyrime tatimore</b>		
Detyrime për sigurime shoqërore shëndetësore	248,173	256,025
Shteti për tatime e taksa		
Tatim mbi të ardhurat personale	0	0
Tatim mbi fitimin	0	0
Tvsh për tu paguar	452,401	207,113
Të tjera tatime për tu paguar	0	0
Tatim në burim	12,672	21,748
Shuma Shteti për tatime e taksa	465,073	228,861
<b>Shuma Detyrimet e Tatimore</b>	<b>713,246</b>	<b>484,886</b>
<b>Hua të tjera</b>		
Debitore të tjera kreditore të tjera	0	0
Dividende për tu paguar	0	0
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	0	0
<b>Shuma hua të tjera</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Parapagimet e arketuara</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Shuma Huate dhe Parapagimet</b>	<b>38,781,982</b>	<b>21,379,868</b>

# “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarive sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi ka gjykuar se të drejtat e furnitorëve janë të vlerësuara realisht.

“Detyrimet për sigurime shoqërore e shëndetësore” përfaqësojnë detyrimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor 2014.

“Shteti për tatim taksa” pasqyrojnë detyrimin për TVSH dhe për tatimin mbi të ardhurat personale të muajit Dhjetor 2014.

## 11. Detyrimet afatgjata-Huate

Huat afatgjata përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>Hua bono dhe detyrime nga qeraja financiare</b>		
Bankat	16,390,000	22,350,000
Qeraja financiare		
<b>Shuma Hua bono dhe detyrime nga qeraja financiare</b>	16,390,000	22,350,000
<b>Hua të tjera afatgjata</b>	9,000,000	
<b>Shuma Hua afatgjata</b>	<b>25,390,000</b>	<b>22,350,000</b>

Ne 09.12.2013 nga "ALPHA" Bank sh.a është marrë hua afatgjatë në shumën 29.800.000 leke, me afat vlefshmerie deri me datë 22.07.2018, me shlyerje me kështu tremujore dhe me normë interesi e përbërë nga norma e referimit dhe marzhi normës së interesit si më poshtë:

- Norma e interesit për lekun është norma e bonove të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare me një afat një vjeçar.
- Marzhi i normës së interesit është +250 (dyqind e pesëdhjet) pike baze për monedhën leke, ku çdo pike baze përfaqëson një të qintën e një përqindshit. Pavarësisht sa kësaj norme minimale e interesit do të jetë 7.5%.

Nga kjo kredi shuma prej 5.960.000 leke, që përfaqëson kredinë që do të shlyet në 12 muajt e ardhshëm, është klasifikuar afatshkurter.

## 12. Kapitalet e veta

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbehet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>Kapitali i paguar</b>	88,138,000	59,238,000
<b>Shuma Kapitali themeltar</b>	<b>88,138,000</b>	<b>59,238,000</b>

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në bilanc, është i njëjti me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKR. Me datë 31.12.2014 kapitali i regjistruar i shoqërisë është 88.138.000 leke. Gjate ushtrimit kontabel 2014 nuk ka ndryshime në raportet e zoterimit të kapitalit të regjistruar.

## 13. Fitimi(humbja) e vitit financiar

### 13.1 Shitjet neto

## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

*Shumat shprehen në lekë*

Shitjet neto perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>Shitje e produkteve te gateshme</b>	4,606,726	4,361,196
<b>Shitja e punimeve dhe e sherbimeve</b>	2,925,934	4,383,993
<b>Shitje mallrash</b>	358,863,255	383,991,481
<b>Shuma Shitje neto</b>	<b>366,395,915</b>	<b>392,736,670</b>

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatat e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.

### **13.2 Shpenzimet per Mallrat, lendet e para dhe sherbimet**

Shpenzimet per Mallrat, lendet e para dhe sherbimet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Blerje/Shpenzime te materialeve	0	0
Blerje/Shpenzime te materialeve te tjera	4,843,862	5,719,632
Blerje/Shpenzime mallrash e sherbimesh	326,737,729	350,692,993
<b>Shuma Mallrat lendet e para dhe sherbimet</b>	<b>331,581,591</b>	<b>356,412,625</b>

Konsumi i mallrave, materialeve, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme dhe i perkasin ushtrimit 2014.

### **13.3 Shpenzime te personelit**

Shpenzime te personelit perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
Pagat dhe shperblimet e personelit	10,731,173	11,667,335
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	1,792,108	1,948,450
<b>Shuma Shpenzime te personelit</b>	<b>12,523,281</b>	<b>13,615,785</b>

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

### **13.4 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit**

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si vijon:



## “KAJO” SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>Shpenzime nga te trete dhe shpenzime te tjera</b>		
Mirembajtje e riparime	135,617	335,458
Sigurime	318,342	242,525
Honorare	125,000	150,000
Te tjera	159,266	177,660
Udhetim e dieta	294,000	229,000
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	604,132	627,218
Shpenzime transporti	0	0
Shpenzime per sherbimet bankare	31,716	39,829
Materiale kancelari etj	0	0
<b>Shuma shpenzime</b>	<b>2,268,073</b>	<b>2,403,190</b>
<b>Tatime dhe taksa</b>		
Taksa tarifa doganore(pa perfshira ne kostot e blerjes)	0	0
Taksa dhe tarifa vendore	320,240	205,040
Tatime te tjera	164,059	258,268
<b>Shuma Tatime dhe taksa</b>	<b>484,299</b>	<b>463,308</b>
<b>Gjoha demshperblime</b>	<b>816,817</b>	<b>576,167</b>
<b>Humbje nga rivleresimi/Shitja e aktiveve</b>		
Vlera kontabel Neto e mbetur e AAM	1,031,333	1,066,665
<b>Shuma Humbje nga rivleresimi/Shitja e aktiveve</b>	<b>1,031,333</b>	<b>1,066,665</b>
<b>Shuma Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>4,600,522</b>	<b>4,509,330</b>

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane regjistruar me shumen e paguar ose te pagueshme.

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

“Gjoha e demshperblime” perfaqesojne detyrimet dhe saksionet tatimore te rezultuara nga njoftim vleresimet e vitit 2014. Ato jane rimarre ne fitimin tatimor, shenimi nr.13.6.

### 13.5 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet financiare:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat</b>		
Te ardhurat nga interesat	0	375
Shpenzime per interesa	9,505,085	10,041,722
<b>Shuma te ardhura dhe shpenzime nga interesat</b>	<b>(9,505,085)</b>	<b>(10,041,347)</b>
<b>Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit</b>		
Fitim nga kembimet valutore	0	0
Humbje nga kembimet valutore	0	2,100
<b>Shuma Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit</b>	<b>0</b>	<b>(2,100)</b>
<b>Te ardhura te tjera financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Shuma e ardhurat dhe shpenzimet financiare</b>	<b>(9,505,085)</b>	<b>(10,043,447)</b>

# "KAJO" SH.P.K

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2014 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

## 13.6 Shpenzimet e Tatim fitimit

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2014 dhe 2013 janë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2014	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013
<b>I FITIMI NETO PARA TATIMT</b>	<b>6,771,864</b>	<b>6,893,326</b>
<b>II SHPENZIME TE PA ZBRITESHME (+)</b>	<b>816,817</b>	<b>577,667</b>
1 Amortizimi tej normave fiskale		
2 Shpenzime për pritje e dhurime tej kufirit tatimor		
3 Gjoha, penalitete, demshperblime	816,817	577,667
4 Provizione që nuk njihen		
5 Shpenzime pa dokumenta të rregullta		
6 Te tjera materiale jashtë përdorimit pa miratim		
<b>III PJESA E HUMBYES SE MBARTUR (-)</b>		
<b>IV FITIM (HUMBJA) TATIMORE (I+II-III)</b>	<b>7,588,681</b>	<b>7,470,993</b>
<b>V SHPENZIMET E TATIMIT MBI FITIMIN (10%)</b>	<b>1,138,302</b>	<b>747,099</b>
<b>VI FITIMI(HUMBJA) NETO E USHTRIMIT(I-V)</b>	<b>5,633,562</b>	<b>6,146,227</b>

Tatim fitimi i ushtrimit është llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili është rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar në tabelën e mësipërme.

## 14. Transaksione të paleve të lidhura

Në marrjen në konsideratë të çdo transaksioni dhe marrëdhënie të mundshme, jo thjesht formën ligjore të tyre, në 31 dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 ka transaksione normale me palet të lidhura.

## 15. Ngjarjet pas dates së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas dates së miratimit të pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performancës financiare të shoqërisë, rezultoi se në ushtrimin 2014 shoqëria ka stabilitet dhe zhvillim normal të biznesit. Drejtimi gjykon se për vitin në vazhdim nuk ka rreziqe të ndërprerjes së veprimtarisë së shoqërisë.

## 16. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese të deklaruara në pasqyrat financiare 2013 janë të njëjta me ato të prezantuara në vitin aktual 2014.

**HARTUESI**

**PËR SHOQËRINË TREGTARE "KAJO" SH.P.K**

**LEFTER DOKO**



**ADMINISTRATORI**

**SHKËLQIM KAJO**



KAJO SHPK  
BERAT  
K 52602003C